L I G J
Nr.8414, datë 1.10.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8167, DATË 21.11.1996 "PËR SHËRBIMIN SHËNDETËSOR STOMATOLOGJIK"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8167, datë 21.11.1996 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik", neni 3 ndryshohet si vijon:

"Shërbimi shëndetësor stomatologjik, profilaktik dhe mjekues mbulohet nga buxheti i shtetit:

1. Plotësisht:

a) për moshat nën 18 vjeç;

b) për të shtruarit dhe për ata që trajtohen në institucionet spitalore, shtetërore, për rastet e mjekimeve urgjente;

c) për kategori individësh, të përcaktuara në dispozita ligjore;

ç) për shërbimin e urgjencave stomatologjike, për moshat mbi 18 vjeç, sipas përcaktimeve të bëra nga Ministria e Shëndetësisë;

d) për trajtime mjekësore stomatologjike, në terapi dhe kirurgji, në departamentin e stomatologjisë së Fakultetit të Mjekësisë.

2. Pjesërisht, me tarifa të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe të miratuara nga Ministria e Financave:

a) për shërbime stomatologjike, ortopedike në departamentin e stomatologjisë së Fakultetit të Mjekësisë;

b) për shërbime stomatologjike në institucionet shtetërore, pa subvencion nga shteti ose me drejtim ekonomik."

Neni 2

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"Shërbimi shëndetësor stomatologjik, publik dhe privat, kontrollohet nga strukturat e:

- shërbimit stomatologjik në Ministrinë e Shëndetësisë;
- shërbimit stomatologjik të drejtorive të shëndetit publik;
- Inspektoratit Sanitar Shtetëror, të bazuar në ligjin nr.7643, datë 2.12.1992 "Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror";
- Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet në Ministrinë e Shëndetësisë, të bazuar në ligjin nr.8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese";
- Inspektoratit Epidemiologjik, bazuar në ligjin nr. 7761, datë 18.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse".

Organet e mësipërme mund të bashkëpunojnë me "Shoqatën e stomatologëve", duke aktivizuar në grupet e kontrollit, të organizuara prej tyre, specialistë të rekomanduar nga shoqata."

Neni 3

Neni 12 ndryshohet si vijon:

"Veprimtaria profilaktike, mjekuese dhe diagnostikuese ortodontike dhe procesi diagnostikues në institucionet stomatologjike publike kryhet nga mjekët stomatologë dhe asistentët përkatës."

Neni 4

Neni 19 ndryshohet si vijon:

"Shkeljet e rregullave të parashikuara në nenet 3, 4, 8, 10, 14 dhe 17 të këtij ligji, kur nuk formojnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga organet e përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji, si më poshtë:

a) Për ushtrim profesioni pa licencë në fushën e stomatologjisë, me gjobë nga 10 000 deri në 50 000 lekë dhe në rast mospajisjeje me licencë brenda një afati 2 mujor, me pezullimin e veprimtarisë dhe deri në mbylljen e klinikës.

b) Për hapjen e institucioneve shëndetësore stomatologjike private pa licencë, me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë dhe në rast mospajisjeje me licencë, brenda një afati 2 mujor, me pezullimin e veprimtarisë dhe deri në mbylljen e institucionit.

c) Për mosrealizimin e kushteve të nevojshme për ushtrimin e shërbimit stomatologjik në institucionet shkollore, me gjobë nga 10 000 deri në 20 000 lekë, deri në pezullimin e veprimtarisë.

ç) Për mosafishimin e çmimeve të shërbimit, me gjobë nga 1 000 deri në 5 000 lekë.

d) Për mosrealizimin e shërbimit stomatologjik për moshat nën 18 vjeç, të të shtruarve në spitale, të kategorive të përcaktuar në dispozitat ligjore dhe urgjencat për të rritur, me gjobë nga 10 000 deri në 50 000 lekë.

dh) Për mospërmbushjen e detyrimeve ndaj kontratës së lidhur ndërmjet palëve për realizimin e shërbimit, me gjobë nga 10 000 deri në 50 000 lekë ose me heqjen e licencës.

e) Për ushtrimin e veprimtarisë mjekuese me pacientë nga laborantët dentarë, me gjobë nga 10 000 deri 50 000 lekë ose me heqjen e licencës."

Neni 5

Në të gjitha dispozitat e ligjit nr.8167, datë 21.11.1996 "Për shërbimin shëndetësor stomatologjik", fjalët "Ministria e Shëndetësisë dhe e Mjedisit" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Shëndetësisë", kurse fjalët "Ministria e Arsimit dhe Sporteve" dhe "Ministria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore" zëvendësohen me fjalët "Ministria e Arsimit dhe e Shkencës".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2234, datë 15.10.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani